



20 - 26 TETOR
JAVA E MBROJTJES

ÇELET PROGRAM I RI MASTER NË INXHINIERI ARMATIMI

Universiteti “Ismail Qemali” në Vlorë, në bashkëpunim me Akademinë e Forcave të Armatosura (AFA) ka çelur programin e ri të studimeve Master Profesional në Inxhinieri Armatimi, me profil në Aviacion dhe Naval, një program unik, që hapet për herë të parë në Shqipëri. Në fjalën e tij përshëndetëse, ministri Vengu vlerësoi bashkëpunimin mes institucioneve akademike dhe atyre ushtarake si një hap domethënës drejt ndërtimit të një ekosistemi të ri dijeje, inovacioni dhe veprimi praktik.

★★★★★



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E MBROJTJES

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E FINANC

KONTROLL MË EFEKTIV NDAJ MALLRAVE USHTARAKE

Në prani të ministrit të Mbrojtjes Pirro Vengu dhe atij të Financave Petrit Malaj, u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve. Marrëveshja u firmos nga drejtori i Përgjithshëm i Doganave Genti Gazheli dhe drejtori i AKSHE, Andrea Shllaku. Marrëveshje ka si qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve për lehtësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi dhe për zhvillimin e veprimtarive të përbashkëta në fushën e kontrollit të mallrave me përdorim të dyfishtë dhe atyre ushtarake.

★★★★★

MINISTRI VENUGU TAKON REKRUTËT DHE KADETËT NË BUNAVI

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, vizitoi Bunavinë, ku përshëndeti 149 rekrutë të rinj dhe 76 kadetë të vitit të parë të Akademisë së Forcave të Armatosura, që sapo kanë nisur rrugëtimin e tyre në uniformë. Gjatë vizitës, ministri inspektoi gjithashtu punimet e rehabilitimit të godinave të bazës, pjesë e fazës së parë të modernizimit, dhe njoftoi dislokimin e një kompanie të sapokrijuar të Bazës Mbështetëse të Emergjencave Civile, duke forcuar kapacitetet e mbrojtjes civile në Jug-Perëndim të vendit.

★★★★★

STËRVITJE E PËRBASHKËT ME MALIN E ZI

Toga e Armëve të Rënda K1K, pjesë e Batalionit të Parë të Regjimentit të Këmbësorisë së Jugut, zhvilloi një stërvitje të përbashkët me forcat e Malit të Zi me temë “Lëvizjet dhe taktikat në operacione urbane”. Aktiviteti, i zhvilluar në ambientet e ROS, kishte për qëllim rritjen e ndërveprimit dhe shkëmbimin e përvojave taktike mes dy palëve.



Le të sulmohen në luftë në fjalë të luftës, që të na shpëtojë nga zjarri i shenjtë i lirisë dhe le të vëmë trupin nga dehja e barutit,
që të na shpëtojë nga zjarri i shenjtë i lirisë dhe le të vëmë trupin nga dehja e barutit,
thirrur: "Rroftë Shqipëria!"
Fan Noli

NIKO KOTHERJA, DREJTOR I MUZEUT TË FORCAVE TË ARMATOSURA

Niko Kotherja është emëruar në krye të Muzeut të Forcave të Armatosura, duke hapur një kapitull të ri për këtë institucion. Muzeu, që ruan historinë dhe trashëgiminë e ushtrisë shqiptare, pritet të forcojë rolin e tij si qendër e kujtesës kombëtare dhe si pikë interesi për qytetarët dhe turistët.

JM



EOD PASTRON TERRITORIN NGA MUNICIONET

Operatorët EOD të Batalionit të Xhenios kanë realizuar me sukses detyra për pastrimin e territorit nga municione të identifikuara në bashkitë Përrenjas, Himarë dhe Elbasan. Në çdo operacion, ekipet e specializuara kanë kryer kontrollin, vlerësimin, asgjësimin dhe transportimin e municioneve luftarake të rrezikshme, duke garantuar sigurinë e qytetarëve dhe mbrojtjen e pronës.

★★★★★

TRE ANIJE ITALIANE VIZITOJNË UJËRAT TERRITORIALE SHQIPTARE

Tre anije të Forcës Detare italiane vizituan ujërat territoriale shqiptare në kuadër të stërvitjeve dhe trajnimeve të përbashkëta. Nënadmirali Adnand Agastra zhvilloi një vizitë në bordin e anijes SPICA, ku u prit nga komandanti i saj Davide De Pozzo. Gjatë aktivitetit u diskutua rëndësia e bashkëpunimit ndërmjet forcave detare të dy vendeve dhe siguria rajonale detare.

★★★★★

URA “BAILEY” MBI LUMIN DRIN NË DIBËR

Ekspertët xhenier të Kompanisë së Urave kanë nisur punimet për riparimin e urës metalike tip “Bailey”, mbi lumin Drin, në njësinë administrative Muhurr, bashkia Dibër. Operacioni përfshin ndërrimin e elementëve të dëmtuar dhe centrimin e strukturës, me qëllim rikthimin e funksionalitetit të plotë të urës. Pas përfundimit të punimeve, ura do të ketë një pamje të përmirësuar dhe kapacitet mbajtës më të lartë, duke garantuar siguri më të madhe për banorët dhe automjetet që e përdorin.

★★★★★